



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3376/10 prot.

Datë 26.01.2026

V E N D I M
Nr. 134/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nenkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.01.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Isometric” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-63108-09-30-2025, me objekt: “Loti 5: “Blerje kolona kromatografike”, me fond limit 8,835,108.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BionicTech” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Isometric” SHPK, me NIPT L92207009A dhe adresë: Rruga Dibres Kompleksi Arlis Farmacia 10 shk.2 App. 2, Tiranë: Bulevardi Bajram Curri, pallati Kastrati, Tiranë.

Operatori ekonomik “BionicTech” SHPK, me NIPT M41406021N dhe adresë: Rr. Stavri Themeli, ZK 8220, vol.12, fq.23 me nr. Pasurie 8/307-N2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Perqendruara me adresë: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.5. Operatorët ekonomik ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.10.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-63108-09-30-2025, me objekt: “Loti 5: “Blerje kolona kromatografike”, me fond limit 8,835,108.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Pergendruara.

II.2. Në datën 31.10.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 14.11.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

BionicTech	3,560,320.50	lekë	Skualifikuar
Medfau	5,540,200	lekë	Skualifikuar
Pegasus	6,955,000	lekë	Skualifikuar
Isometric	8,586,800	lekë	Skualifikuar

II.4. Në datën 18.11.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim - anulimi”, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 23.11.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6118 dhe nr.3376/2025 prot, datë 25.11.2025 i operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-63108-09-30-2025, me objekt: “Loti 5: “Blerje kolona kromatografike”, me fond limit 8,835,108.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Pergendruara.

II.5.1. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt,

numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 3376/1 prot., datë 26.11.2025.

II.5.2. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, autoriteti kontraktor në datën 05.12.2025 ka përcjellë pranë KPP vendimin e KSHA nr.145/2025, datë 05.12.2025, protokolluar me tonën me nr.3376/2 prot., datë 09.12.2025, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “BionicTech” SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.5.3.Vendimin e KSHA nr.145/2025, datë 05.12.2025, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK, autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik edhe nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar me tonën me nr.3376/3 prot., datë 09.12.2025.

III.5.4.Operatori ekonomik ankimues“BionicTech” SHPK, në datën 13.12.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, ka paraqitur argumenta pas vendimi të autoritetit kontraktor, argumenta të cilat janë protokolluar me tonën me nr.3376/4 prot., datë 15.12.2025.

II.6. Në datën 24.11.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6121 dhe nr.3379/2025 prot, datë 25.11.2025 i operatorit ekonomik “Isometric” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-63108-09-30-2025, me objekt: “Loti 5: “Blerje kolona kromatografike”, me fond limit 8,835,108.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara

II.6.1. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 3379/1 prot., datë 26.11.2025.

II.6.2. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, autoriteti kontraktor në datën 10.12.2025 ka përcjellë vendimin e KSHA nr.148/2025, datë 09.12.2025, protokolluar me tonën me nr.3379/2 prot., datë 10.12.2025, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Isometric ” SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin e plotë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Isometric” SHPK duke argumentuar si më poshtë vijon:

[...] Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se në përmbushje të kërkesës së përcaktuar sipas pikës 2.3.3 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik ankimues

nëpërmjet zinxhirit të autorizimeve të paraqitura ka arritur të dëshmojë lidhjen e distributorit me prodhuesin. Përkundër skualifikimit të Komisionit të Vlerësimit të ofertave, në asnjë nga letrat e autorizimeve të cilat përbëjnë zinxhirin e autorizimi ku operatori ekonomik fundor i autorizuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi dhe për të ofruar produktet e kërkuara është subjekti "ISOMETRIC" shpk, lejohet, pra nuk ndalohej tregtimi i artikujve të prodhuesit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se në tregun e lirë të pajisjeve laboratorike, marrëdhëniet e autorizimit nuk janë të ngurta e të prera, por përkundrazi, janë dinamike, funksionale dhe të ndërtuara mbi parimin themelor të lirisë së kontraktimit dhe të funksionimit të tregut. Për këtë arsye, në rastin konkret një prodhues global, si "Bio-Rad", nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me çdo ofertues në rajone të ndryshme por ndërton një rrjet të organizuar me distributorë rajonalë, sub-distributorë dhe partnerë të autorizuar që mund t'i shërbejnë dhe mund të funksionojnë në tregun lokal.

Në këtë kontekst, duke qenë se nuk ekziston një ndalim i shprehur në formë zyrtare, delegimi i autorizimit nuk duhet të ndërpritet në një nivel të caktuar, dhe nuk janë vendosur kufij apo limite se sa hallka mund të ketë midis prodhuesit dhe ofertuesit final.

Mungesa e ndalimit është pikërisht arsyeja që ky lloj delegimi është plotësisht i vlefshëm. Gjithashtu, duke mbajtur në konsideratë edhe objektin e kontratës dhe llojin e produkteve të kërkuara, kolonat kromatografike, pjesa më e rëndësishme e sistemeve analitike, përmes së cilës ndahen, analizohen dhe identifikohen molekula të ndryshme, si produkte që kërkojnë një shpërndarje të specializuar, kërkohet që të ekzistojë një zinxhir i pandërprerë legjitimiteti, nga prodhuesi deri te ofertuesi dhe në rastin konkret ky zinxhir është i plotë, i qartë dhe i dokumentuar. Autorizimi i deleguar për blerje të kolonave kromatografike nuk është thjesht një dokument formal por është shprehje e një parimi themelor të tregut dhe të funksionimit ekonomik të tij. Në thelb, ky lloj delegimi mbështetet mbi katër shtylla kryesore që e bëjnë këtë veprim jo vetëm të ligjshëm, por edhe të natyrshëm dhe të pranueshëm në praktikën e funksionimit të biznesit dhe tregut të lirë duke krijuar në këtë mënyrë edhe një llojë praktike administrative tregtare të konsoliduar.

Së pari, liria e kontraktimit ku referuar legjislacionit në fuqi për hartimin e kontratave dhe detyrimet kontraktuale rrjedhëse, çdo palë ka të drejtën të vendosë vetë rregullat e marrëdhënieve të saj ekonomike, të caktojë palët e tjera që mund të përfaqësojnë produktet e saj dhe të delegojë detyra të caktuara sipas nevojave të tregut. Ky parim është themelor sepse nuk imponon një model të vetëm por lejon që kompanitë/subjektet operuese të ndërtojnë rrjete distribucioni që i shërbejnë tregut në mënyrë efikase. Në këtë rast, subjekti "Bio-Rad" i ka dhënë autorizimin subjektit "Labena", kjo e fundit ia ka deleguar operatorit ekonomik "Biometric" shpk, dhe më tej, subjekti "Biometric" shpk ia ka deleguar operatorit ekonomik "Isometric" shpk-të drejtën për të marrë pjesë në tender dhe për të tenderit. Ky zinxhir është i ndërtuar mbi bazën e lirisë së kontraktimit, sepse cdo hallkë ka vepruar të mundësuar furnizimin me produktet e kërkuara sipas specifikimeve teknike, pjesë e dokumenteve brenda kompetencave të saj dhe pa asnjë pengesë ligjore që të kufizojë nën-delegimin.

Së dyti, liria e përfaqësimit, një parim që i jep çdo subjekti të autorizuar mundësinë të caktojë një përfaqësues tjetër për të ushtruar të drejtat e tij për një produkt të caktuar. Ky është parimi që e bën të mundur që operatori ekonomik "Biometric" shpk, pa marrë pjesë vetë në tender, t'i japë operatorit të mundësuar furnizimin me produktet e kërkuara. Kjo nuk çënon autorizimin origjinal të prodhuesit dhe as të distributorit, por thjesht e zgjeron rrjetin e mundësive për të operuar në treg, duke siguruar që produkti të arrijë tek klienti përfundimtar/autoriteti përfitues, në mënyrë ligjore dhe të dokumentuar.

Në kontekstin e prokurimit publik, ky proces luan një rol të rëndësishëm edhe në nxitjen e konkurrencës dhe shmangien e riskut potencial nga monopolizimi, duke mbajtur në konsideratë edhe vetë natyrën specifike të produkteve të kërkuara.

Së treti, funksionimi normal i tregut me disa nivele distribucioni ku industria e pajisjeve laboratorike, përfshirë kolonat kromatografike, është një shembull i qartë i një tregu ku prodhuesi ndërkombëtar nuk mund të operojë drejtpërdrejt me çdo laborator lokal. Zinxhiri subjekti "Bio-Rad" → subjekti "Labena" subjekti "Biometric" subjekti "Isometric" nuk është devijim nga praktika, por mënyra standarde e shpërndarjes së produkteve komplekse, që kërkojnë njohuri teknike dhe mbulim lokal. Ky sistem garanton që produktet të arrijnë tek përdoruesi përfundimtar me dokumentacion të plotë, me mbështetje teknike dhe në përputhje me standardet e sigurisë dhe cilësisë. Pra, ky zinxhir autorizimesh është një instrument që mundëson funksionimin efikas të tregut dhe garanton që produktet të arrijnë tek përdoruesi përfundimtar në mënyrë të dokumentuar dhe të ligjshme, duke respektuar të gjitha normat ekonomike dhe ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e tregut të lirë.

Gjithashtu, referuar rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, Nr.3261/5.Prot, datë 27.11.2025, "Rekomandim mbi problematikat e konstatuara gjatë verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik", ndër të tjera, citohet se: "Autoritetet kontraktore që vlerësojnë të kërkojnë nga operatorët ekonomikë, disponimin e autorizimit të prodhuesit/ve ose distributorit të autorizuar prej prodhuesit vetëm për disa nga artikujt e kërkuar objekt prokurimi, duhet të japin arsye konkrete apo të argumentojnë kërkesën për këto dokumente vetëm për disa prej artikujve. Njëkohësisht, duhet të mbajnë në konsideratë edhe faktin që këto artikuj/materiale mund të sigurohen me kontratë furnizimi nga furnizues të ndryshëm, të cilët janë palë të treta në procedurë". Në këtë rekomandim, kombinohet nevoja për siguri dhe verifikim të origjinës së produkteve me fleksibilitetin që kërkohet në tregun modern dhe në këtë kontekst legjitimohet dhe konsiderohet e rregullt ekzistenca e distributorit, nën-distributorit, partneritetit tregtar dhe marrëdhënieve komerciale midis palëve të treta. Pra, nën-autorizimi ose autorizimi i dhënë nga distributori për një operator tjetër është një situatë që vetë Agjencia e Prokurimit Publik e ka parashikuar dhe pranuar si normale në kuptimin e funksionit të tregut të lirë dhe në korelacion me qëllimin e procedurave të prokurimit publik.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "ISOMETRIC" shpk. [...].

II.6.3.Vendimin e KSHA nr.148/2025 prot., datë 09.12.2025, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "Isometric" SHPK, autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik edhe nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar me tonën me nr.3379/3 prot., datë 11.12.2025.

II.7. Me shkresën nr. 3376/5prot., datë 13.01.2026, me qëllim gjykimin e drejtë dhe objektiv të çështjes, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik "BionicTech" SHPK, për zhvillimin e një seance dëgjimore më datë 19.01.2026, ora 12:00, në mjediset e KKP-së.

II.8.Në datën 19.01.2026, ora 12:00 në Komisionin e Prokurimit Publik u zhvillua seanca dëgjimore në prani të të gjitha palëve pjesëmarrëse. Seanca dëgjimore u regjistrua audio në sistemin e ankesave elektronike nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik

II.9. Me shkresën datë 21.01.2026, me lëndë: "*Kthim përgjigje sipas kërkesës së seancës dëgjimore*", protokolluar me tonën me nr.3376/6 prot., datë 21.01.2026, operatori ekonomik "BionicTech" SHPK ka paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik material sqarues në lidhje me specifikimet teknike të kërkuara me ato të ofertuara prej tij.

II.10.Autoriteti kontraktor në datën 21.01.2026, nëpërmjet komunikimit me email ka dërguar në adresën zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik, sqarime shtesë, protokolluar me tonën me nr.3376/7 prot., datë 21.01.2026.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga operatorët ekonomikë të interesuar sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur të saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Isometric” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, autoriteti kontraktor në datën 10.12.2025 ka përcjellë vendimin e KSHA nr.148/2025, datë 09.12.2025, protokolluar me tonën me nr.3379/2 prot., datë 10.12.2025, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Isometric ” SHPK..

III.1.2. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues, “Isometric” SHPK dhe në përfundim ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, si më poshtë:

[...] Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se në përmbushje të kërkesës së përcaktuar sipas pikës 2.3.3 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik ankimues nëpërmjet zinxhirit të autorizimeve të paraqitura ka arritur të dëshmojë lidhjen e distributorit me prodhuesin. Përkundër skualifikimit të Komisionit të Vlerësimit të ofertave, në asnjë nga letrat e autorizimeve të cilat përbëjnë zinxhirin e autorizimi ku operatori ekonomik fundor i autorizuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi dhe për të ofruar produktet e kërkuara është subjekti "ISOMETRIC" shpk, lejohet, pra nuk ndalohet tregtimi i artikujve të prodhuesit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se në tregun e lirë të pajisjeve laboratorike, marrëdhëniet e autorizimit nuk janë të ngurta e të prera, por përkundrazi, janë dinamike, funksionale dhe të ndërtuara mbi parimin themelor të lirisë së kontraktimit dhe të funksionimit të tregut. Për këtë arsye, në rastin konkret një prodhues global, si "Bio-Rad", nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me çdo ofertues në rajone të ndryshme por ndërton një rrjet të organizuar me distributorë rajonalë, sub-distributorë dhe partnerë të autorizuar që mund t'i shërbejnë dhe mund të funksionojnë në tregun lokal.

Në këtë kontekst, duke qenë se nuk ekziston një ndalim i shprehur në formë zyrtare, delegimi i autorizimit nuk duhet të ndërpritet në një nivel të caktuar, dhe nuk janë vendosur kufij apo limite se sa hallka mund të ketë midis prodhuesit dhe ofertuesit final.

Mungesa e ndalimit është pikërisht arsyeja që ky lloj delegimi është plotësisht i vlefshëm. Gjithashtu, duke mbajtur në konsideratë edhe objektin e kontratës dhe llojin e produkteve të kërkuara, kolonat kromatografike, pjesa më e rëndësishme e sistemeve analitike, përmes së cilës ndahen, analizohen dhe identifikohen molekula të ndryshme, si produkte që kërkojnë një

shpërndarje të specializuar, kërkohet që të ekzistojë një zinxhir i pandërprerë legjitimiteti, nga prodhuesi deri te ofertuesi dhe në rastin konkret ky zinxhir është i plotë, i qartë dhe i dokumentuar. Autorizimi i deleguar për blerje të kolonave kromatografike nuk është thjesht një dokument formal por është shprehje e një parimi themelor të tregut dhe të funksionimit ekonomik të tij. Në thelb, ky lloj delegimi mbështetet mbi katër shtylla kryesore që e bëjnë këtë veprim jo vetëm të ligjshëm, por edhe të natyrshëm dhe të pranueshëm në praktikën e funksionimit të biznesit dhe tregut të lirë duke krijuar në këtë mënyrë edhe një llojë praktike administrative tregtare të konsoliduar.

Së pari, liria e kontraktimit ku referuar legjislacionit në fuqi për hartimin e kontratave dhe detyrimet kontraktuale rrjedhëse, çdo palë ka të drejtën të vendosë vetë rregullat e marrëdhënieve të saj ekonomike, të caktojë palët e tjera që mund të përfaqësojnë produktet e saj dhe të delegojë detyra të caktuara sipas nevojave të tregut. Ky parim është themelor sepse nuk imponon një model të vetëm por lejon që kompanitë/subjektet operuese të ndërtojnë rrjete distribucioni që i shërbejnë tregut në mënyrë efikase. Në këtë rast, subjekti "Bio-Rad" i ka dhënë autorizimin subjektit "Labena", kjo e fundit ia ka deleguar operatorit ekonomik "Biometric" shpk, dhe më tej, subjekti "Biometric" shpk ia ka deleguar operatorit ekonomik "Isometric" shpk-të drejtën për të marrë pjesë në tender dhe për të tenderit. Ky zinxhir është i ndërtuar mbi bazën e lirisë së kontraktimit, sepse cdo hallkë ka vepruar të mundësuar furnizimin me produktet e kërkuara sipas specifikimeve teknike, pjesë e dokumenteve brenda kompetencave të saj dhe pa asnjë pengesë ligjore që të kufizojë nën-delegimin.

Së dyti, liria e përfaqësimit, një parim që i jep çdo subjekti të autorizuar mundësinë të caktojë një përfaqësues tjetër për të ushtruar të drejtat e tij për një produkt të caktuar. Ky është parimi që e bën të mundur që operatori ekonomik "Biometric" shpk, pa marrë pjesë vetë në tender, t'i japë operatorit të mundësuar furnizimin me produktet e kërkuara. Kjo nuk çënon autorizimin origjinal të prodhuesit dhe as të distributorit, por thjesht e zgjeron rrjetin e mundësive për të operuar në treg, duke siguruar që produkti të arrijë tek klienti përfundimtar/autoriteti përfitues, në mënyrë ligjore dhe të dokumentuar.

Në kontekstin e prokurimit publik, ky proces luan një rol të rëndësishëm edhe në nxitjen e konkurrencës dhe shmangien e riskut potencial nga monopolizimi, duke mbajtur në konsideratë edhe vetë natyrën specifike të produkteve të kërkuara.

Së treti, funksionimi normal i tregut me disa nivele distribucioni ku industria e pajisjeve laboratorike, përfshirë kolonat kromatografike, është një shembull i qartë i një tregu ku prodhuesi ndërkombëtar nuk mund të operojë drejtpërdrejt me çdo laborator lokal. Zinxhiri subjekti "Bio-Rad" → subjekti "Labena" subjekti "Biometric" subjekti "Isometric" nuk është devijim nga praktika, por mënyra standarde e shpërndarjes së produkteve komplekse, që kërkojnë njohuri teknike dhe mbulim lokal. Ky sistem garanton që produktet të arrijnë tek përdoruesi përfundimtar me dokumentacion të plotë, me mbështetje teknike dhe në përputhje me standardet e sigurisë dhe cilësisë. Pra, ky zinxhir autorizimesh është një instrument që mundëson funksionimin efikas të tregut dhe garanton që produktet të arrijnë tek përdoruesi përfundimtar

në mënyrë të dokumentuar dhe të ligjshme, duke respektuar të gjitha normat ekonomike dhe ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e tregut të lirë.

Gjithashtu, referuar rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, Nr.3261/5.Prot, datë 27.11.2025, "Rekomandim mbi problematikat e konstatuara gjatë verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik", ndër të tjera, citohet se: "Autoritetet kontraktore që vlerësojnë të kërkojnë nga operatorët ekonomikë, disponimin e autorizimit të prodhuesit/ve ose distributorit të autorizuar prej prodhuesit vetëm për disa nga artikujt e kërkuar objekt prokurimi, duhet të japin arsye konkrete apo të argumentojnë kërkesën për këto dokumente vetëm për disa prej artikujve. Njëkohësisht, duhet të mbajnë në konsideratë edhe faktin që këto artikuj/materiale mund të sigurohen me kontratë furnizimi nga furnizues të ndryshëm, të cilët janë palë të treta në procedurë". Në këtë rekomandim, kombinohet nevoja për siguri dhe verifikim të origjinës së produkteve me fleksibilitetin që kërkohet në tregun modern dhe në këtë kontekst legjitimohet dhe konsiderohet e rregullt ekzistenca e distributorit, nën-distributorit, partneritetit tregtar dhe marrëdhënieve komerciale midis palëve të treta. Pra, nën-autorizimi ose autorizimi i dhënë nga distributori për një operator tjetër është një situatë që vetë Agjencia e Prokurimit Publik e ka parashikuar dhe pranuar si normale në kuptimin e funksionit të tregut të lirë dhe në korelacion me qëllimin e procedurave të prokurimit publik.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "ISOMETRIC" shpk. [...].

III.1.3. Neni 30 i LPP-së i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : "1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Isometric” SHPK, për sa kohë nuk ka ankesë nga operatorë ekonomike të interesuar.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “BionicTech” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij, me arsyet: [...]A.OE nuk plotëson Pikën 2.3.3 të KVK e cila përcakton

3.Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Nga verifikimi i katalogut të ngarkuar në SPE nga OE rezulton se disa nga paisjet e ofruara nuk përkojnë me specifikimet teknike të kërkuara nga AK në DST. OE ka paraqitur një deklaratë nga

prodhuesi CHROMSERVIS sro, i cili deklaron se paisjet janë ekuivalente të atyre të kërkuara dhe plotësojnë specifikimet e kërkuara , po kjo nuk rezulton për të gjitha paisjet si më poshtë:

Nr. Emertimi Specifikime e kerkuara Specifikimet e ofruara nga OE

...3 Kolona Acquity UPLC HSS C18 Acquity UPLC HSS C18

madhesi grimcash 1.8 μm ;

permasat 2.1*100 mm

ARI-5720-BI21 (ARION® Plus C18)

madhesi grimcash 1.7 μm ;

permasat 2.1*100 mm

...11 Kolone analitike Synergi; Polar-RP C18

(100 x 2 mm; 2.5 μm) ARI-5721-EI21(ARION® Polar C18)

(100 x 2.1 mm; 2.2 μm)

13 Kolone Eclips Plus Kolonë Agilent Eclipse Plus C18 1.8 μm ,

2.1*100mm. ARI-5720-BI21 (ARION® Plus C18)

1.7 μm ,

2.1*100mm,

14

Kolone Eclips Zorbax C18; particle size 5 μm ; pore size 95 Å; 250 mm x 4,6mm; analytical

Eclips Zorbax

Agilent;

(P/N: 959990-902) ARI-5720-LM46 (ARION® Plus C18)

particle size 5 μm ; pore size 100 Å;

250 mm x 4,6mm

15

Kolone Eclips Zorbax Plus Agilent; Zorbax Eclipse Plus C18, Rapid Resolution HD

2.1x150mm, 1.8-Micron, PN/959759-902 ARI-5720-BK21 (ARION® Plus C18)

2.1x150mm, 1.7-Micron

17

Kolone jon shkembyese Aminex HPX 87 H BIO RAD (column size: 300 mm × 7.8 mm; Cat:

125-

0140 AST-5927-VN80 ASTRA® Sugar H

(S) HPLC column,

10 μm 300 mm × 8,0 mm

19

Kolone jon shkembyese Aminex HPX 87 H BIO

RAD

(column size: 300 mm × 7.8 mm; particle size: 9 μm) equipped ëith a Carbo H BIO RAD precolumn;

AST-5927-VN80 +

Guard column AGS- 5906-JFC +

coupler JR26054 ASTRA® Sugar H

(S) HPLC

column, 10µm 300 mm × 8,0mm

21

Kolone Poroshell Kolonë Agilent Poroshell 120SB-C18 2.7µm,

2.1*100mm (PN:685775-

902T) CSH-5722-GI21 (CHROMSHELL®

C18 Plus)

2.6µm, 2.1*100mm

22

Kolone SPE Strata-X SPE 30 mg/1 mL;

33 µm; 20 copë për pako ose ekuivalente ne

sasi SPE-5804-AA01

SpeExtra™ HLB Clinical SPE column,

30µm, 30 mg, 1 ml, 50

pcs

OE skualifikohet për mplotësim të pikës 2.3.3 të Kriterëve të vecanta për kualifikim,

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1.Në dokumentet e tenderit, shtojca 8/2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.3, “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

3.Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Ndërsa në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, bashëngjitur dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

KOLONA KROMATOGRAFIKE- 2025, LOTI 5				
NR.	EMERTIMI	SPECIFIKIME_TKNIKE	NJESIA	SASIA E PRITSHME
1	Guard column	Lichrosorb RP8, Gjatesia 10mm, madhesi e poreve 100 Å, diametri i brendshem 3,2 mm; madhesi grimcash 5 µm. 5scope/pako	pako	1
2	HPLC Column Inertsil ODS-4	HPLC Column Inertsil ODS-4 100Å, 5µm, 4.6 x 250mm	Copë	2
3	Kolona Acquity UPLC HSS C18	Acquity UPLC HSS C18 1.8 µm;2.1*100 mm	Copë	1
4	Kolona SPE	Agilent, Bond Elut C18 6cc;Vacuum cartridge;100mg sorbent. 30/pk. Part nr:12102161	pako	20
5	Kolona SPE	Waters OASIS HLB 6cc;Vacuum cartridge;200mg sorbent;30 µm. 30/pk. SKW:WAT106202	Pako	30
6	Kolone	Shim-pack XR-ODS III HPLC column (150 x 2.0 mm; 2.2 µm)	Copë	2
7	Kolone	Agilent Poroshell 120 EC-C18 analytical column (100 mm x 3 mm; 2.7 µm);	Copë	1
8	Kolone	Lichrosorb RP8 - C8; me gjatesi 150 mm me diameter 4.6 mm dhe madhesia poreve 5 µm;	Copë	1
9	Kolone	Zorbax SAX; permasa 250 mm x 4.6 mm; particle size 5 µm;	Copë	1

10	Kolone	Acclaim Polar Advantage II C18; dimensione 250 mm × 4.6 mm; madhesia poreve 5 µm;	Copë	1
11	Kolone analitike	Synergi; Polar-RP C18 (100 x 2 mm; 2.5µm)	Copë	1
12	Kolonë analitike HPLC	HPLC column Agilent Zorbax Eclipse XDB-C18 250 × 4.6 mm; 5 µm;	Copë	4
13	Kolone Eclips Plus	Kolonë Agilent Eclipse Plus C18 1.8µm, 2.1*100mm.	cope	2
14	Kolone Eclips Zorbax	C18; particle size 5µm; pore size 95 Å; 250 mm x 4,6mm; analytical Eclips Zorbax Agilent; (P/N: 959990-902)	cope	2
15	Kolone Eclips Zorbax Plus	Agilent; Zorbax Eclipse Plus C18, Rapid Resolution HD 2.1x150mm, 1.8-Micron, PN/959759-902	cope	4
16	Kolone GC	Agilent GC Columns, PN/ 19091S-433UI;	cope	6
17	Kolone jon shkembyses	Aminex HPX 87 H BIO RAD (column size: 300 mm × 7.8 mm; Cat: 125-0140	cope	1
18	Kolone jon shkembyses	Aminex HPX 87 P BIO RAD (column size: 300 mm × 7.8 mm;	cope	1
19	Kolone jon shkembyses	Aminex HPX 87 H BIO RAD (column size: 300 mm × 7.8 mm; particle size: 9 µm) equipped with a Carbo H BIO RAD precolumn;	Copë	1
20	Kolonë kapilare pë analizimin e FAME	Cappilary column Zebron ZB-FAME GC Cap; Column 30m x 0.25mm x 0.2µm;	Copë	1

21	Kolone Poroshell	Kolonë Agilent Poroshell 120SB-C18 2.7um, 2.1*100mm (PN:685775-902T)	cope	2
22	Kolone SPE	Strata-X SPE 30 mg/1 mL; 33 µm; 20 copë për pako ose ekuivalente ne sasi	Pako	25
23	Kolone Supelcosil 150	LC-18; 15cmx4.6mm, 5um; SUPELCOSIL	cope	2
24	Kolone Supelcosil 250	Kolonë supelcosil LC 18 DB 25 cmx 4.6 mm, 5 µm P/N 58355-U	cope	2
25	SPE cartdrige	Supelclean C18 SPE Tube (500mg/3mL);pako me 50 cope ose ekuivalent ne sasi.	Pako	10

III.2.2.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “BionicTech” SHPK, për plotësimin e kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Shtojca 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” ku operatori ekonomik ka plotësuar Pjesën III “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit” A: Deklaratë “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”.
- Broshura_1_compressed.
- Broshura_2_compressed

III.2.3. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndyshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.2.4. Në nenin 40 pika 6 germa b) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

[...]

III.2.5..Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” , i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes

dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe pretendimeve të këtij të fundit lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, KPP gjykoi të arsyeshme zhvillimin e një seance dëgjimore audio. Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.* Komisioni, në jurisprudencën e tij, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Për sa më sipër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin administrativ, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në shqyrtimin administrativ, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar, dhe për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues dhe ligjor për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Ndaj për këtë qëllim, Komisioni organizoi një seancë dëgjimore me praninë e operatorit ekonomik ankimues “Bionic Tech” SHPK dhe përfaqësuesve të autoritetit kontraktor, për të kryer një ballafaqim lidhur me specifikimet teknike të paraqitura nga operatori ekonomik “Bionic Tech” SHPK dhe ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor, për produktet objekt prokurimi, për të cilat komisioni i vlerësimit të ofertave ka vlerësuar mospërmbushje.

III.2.8.Në datën 19.01.2026, në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt seanca dëgjimore audio për procedurën e prokurimit objekt – gjykimi në prani të përfaqësuesit të operatorit ekonomik “Bionic Tech” SHPK, përfaqësuesve të autoritetit kontraktor dhe në prezencë të anëtarëve të Komisionit Prokurimit Publik. Mbajtja e kësaj seance dëgjimore audio lidhet në thelb me evidentimin e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi të ofertuara nga operatori ekonomik “Bionic Tech” SHPK, nëse këto mallra janë sipas specifikimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor, pasi arsyet e skualifikimit të këtij operatori ekonomik lidhen pikërisht me mospërmbushjen e specifikimeve teknike të disa prej produkteve të ofertuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Në seancën dëgjimore, Komisioni Prokurimit Publik i drejtoi pyetje përfaqësuesve të autoritetit kontraktor se, referuar nenit 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në cilën prej metodave janë bazuar për hartimin e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi?

Përfaqësuesi i autoritetit kontraktor deklaroi ndër të tjera se specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar nga organi përfitues (në rastin konkret Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare, ISUV) dhe nga ana e operatorëve ekonomikë nuk ka pasur pretendime lidhur me këto specifikime gjatë periudhës së publikimit të njoftimit të kontratës.

Në seancë dëgjimore KPP i la detyrë autoritetit kontraktor për të paraqitur në mënyrë shkresore metodat që përdoren nga organi përfitues për kryerjen e analizave, standartet shqiptare ose ato ndërkombëtare në të cilat mbështet, si dhe problematikat që sjellin devijimet e përmasave të ofertuara nga operatori ekonomik ankimues me ato të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Sa i përket përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankimues, nga ana e tij gjatë seancës është bërë evidentimi i specifikimeve teknike të ofertuara, duke i paraqitur në katalogët e ngarkuar në SPE, nga ku rezultoi se specifikimet teknike të ofertuara për mallrat objekt prokurimi, për të cilat nga ana e KVO është vlerësuar mospërmbushje ka rezultuar si më poshtë vijon:

Sa i përket evidentimit të specifikimeve teknike për artikullin nr.1 dhe artikullin nr.2, përkrahësit për artikullin nr. 1, *evidentimi i madhësisë së poreve, madhësisë së grimcave dhe sasisë që do të ofertohej*; për artikullin nr.2, *madhësia e poreve dhe madhësia e grimcave*, nga ana e përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankimues është kërkuar kohë për paraqitjen e shpjegimeve shtesë lidhur me këta dy artikuj.

Sa i përket artikujve të tjerë, (artikujt nr. 3,4,7,11,12,17,19,20 dhe 22) për të cilët nga ana e KVO është vlerësuar mospërmbushje e specifikimeve teknike, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson të evidentojë faktin se, në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike” të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar shprehimisht:

..... *Specifikimi i Materialeve:*

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Bashkëlidhur DST do të gjeni specifikimet teknike për secilin lot .

Shënim: Për çdo certifikatë, standard, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Nga përcaktimi i bërë sa më sipër nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka lejuar **ekuivalencën** e mallrave objekt prokurimi. Referuar katalogëve të paraqitur nga ankimuesi në SPE, nga shqyrtimi i specifikimeve të ofertuara për mallrat objekt prokurimi të sipërcituara, për të cilat nga ana e KVO është vlerësuar mospërmbushje e specifikimeve të kërkuara në dokumentat e tenderit, si dhe nga shpjegimet e dhëna nga përfaqësuesi i ankimuesit gjatë seancës dëgjimore, Komisioni konstaton se, nga ana e operatorit ekonomik ankimues, janë paraqitur mallra objekt prokurimi të cilat, sipas deklaramentit të bërë edhe nga përfaqësuesi i autoritetit kontraktor përmbushin funksionin e pajisjes së kërkuar, por çenojnë metodikën që përdoret nga autoriteti përfitues (ISUV).

III.2.9. Komisioni i Prokurimit Publik, pas zhvillimit të seancës dëgjimore, referuar edhe shpjegimeve të dhëna, si nga ana e operatorit ekonomik ankimues përmes materialit shkresor datë 21.01.2026, me objekt “*Kthim përgjigje sipas seancës dëgjimore*”, protokolluar me tonën me nr. 3376/6 prot., datë 21.01.2026, ashtu edhe nga autoritetit kontraktor përmes materialit të përcjellë nëpërmjet emailit të datës 21.01.2026, protokolluar me tonën me nr.3376/7 prot., datë 21.01.2026, vlerëson se, nga ana e operatorit ekonomik ankimues sa i takon artikujve nr. 3,4,7,11,12,17,19,20 dhe 22 , përmbushen specifikimet teknike të kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit. Në dokumentat e tenderit, autoriteti kontraktor ka lejuar ekuivalencën e mallrave që do të ofrohen nga ofertuesit, që do të thotë se mallrat nuk janë të detyruara të jenë të njëjtë me ato të përcaktuara në dokumentat e tenderit, por mund të jenë të ngjashme dhe të plotësojnë kërkesat funksionale dhe teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nga përfaqësuesi i autoritetit kontraktor gjatë seancës dëgjimore është deklaruar se artikujt e sipërpërmendur të ofertuar nga ana e ankimuesit plotësojnë funksionalitetin e pajisjes, por çenojnë metodikën që përdoret nga autoriteti përfitues (ISUV). Në shpjegimet shtesë të autoritetit kontraktor të përcjella pranë KPP pas seancës dëgjimore, autoriteti kontraktor nuk ka arritur të dokumentojë metodat e pretenduara të akredituara nga autoriteti përfitues, duke mos i provuar ato. Sa më sipër arsyetuar Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se artikujt e sipërcituar (3,4,7,11,12,17,19,20 dhe 22) plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara.

Sa i takon shpjegimeve shtesë të dhëna nga operatori ekonomik ankimues përmes materialit shkresor të datës 21.01.2026 pas seancës dëgjimore, lidhur me mospërmbushjen e specifikimeve teknike për artikujt nr. 1 dhe nr. 2, si dhe duke ju referuar katalogut të paraqitur në SPE nga ankimuesi, Komisioni konstaton se:

Sa i përket **artikullit nr. 1. Guard column**, nga ana e operatorit ekonomik ankimues është ofertuar

AGS-5790-RD4 + AGS-5731-000,

Gjatesia 5mm,

madhesi e poreve nuk përcaktohet,

diametri i brendshëm 2.1 mm;

madhesi grimcash nuk përcaktohet.

Sasia nuk përcaktohet.

në të cilin, nuk përcaktohet *madhësia e poreve dhe madhësia e grimcave*, duke mos përmbushur të gjitha specifikimet e kërkuara për mallrat objekt prokurimi. Komisioni rithekson, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në rastin konkret, *madhësia e poreve dhe madhësia e grimcave* janë parametra teknike që kanë rëndësi për funksionalitetin dhe cilësinë e produktit të ofruar, duke patur parasysh edhe natyrën e procedurës objekt prokurimi. Në kushtet kur nga ana e ankimuesit nuk u arrit të evidentohet në katalogun e paraqitur në SPE, *madhësia e poreve dhe madhësia e grimcave* për artikullin nr.1, ky artikull vlerësohet se nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit nga autoritetit kontraktor. Ndërsa, sa i takon sasisë së ofertuar rezulton se nga ana e ankimuesit janë ofertuar 2 paketime me nga 3 copë, pra në total 6, ndërsa në dokumentat e tenderit është kërkuar 5 copë, për rrjedhojë ky specifikim plotësohet.

Sa i përket **artikullit nr. 2. HPLC Column Inertsil ODS-4**, nga ana e operatorit ekonomik ankimues është ofertuar:

ARI-5721-LM46 (ARION® Polar C18)

madhesi e poreve 120Å,

madhesi grimcash 5µm,

permasat 4.6 x 250mm

Komisioni konstaton se ky artikull i ofertuar nga operatori ekonomik ankimues përmbush specifikimet teknike të kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një

procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Isometric” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-63108-09-30-2025, me objekt: “Loti 5: “Blerje kolona kromatografike”, me fond limit 8,835,108.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Isometric” SHPK, në zbatim të vendimit të KSHA nr.148/2025, datë 09.12.2025.
 3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 4. Autoriteti kontraktues të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik ankimues “BionicTech” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.
 5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Isometric” SHPK dhe operatori ekonomik ‘BionicTech’ SHPK.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

